Aksion antidrogë, katër të arrestuar e konfiskohen sasi e heroinës, kokainës e marihuanës

7 mars 2024, 11:24

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se në dy raste të ndara të mërkurën ka konfiskuar heroinë, kokainë dhe marihuanë dhe janë arrestuar katër të dyshuar.

"Këto operacione të suksesshme policore kanë parandaluar qarkullimin transit të narkotikëve nëpër Republikën e Kosovës e njëkohësisht edhe mundësimin e shfrytëzimit për konsumim të brendshëm", ka njoftuar Policia.

Në rastin e parë, hetuesit policorë nga Sektori Qendror në Prishtinë, kanë identifikuar një të dyshuar për trafikim me lëndë narkotike dhe kanë siguruar të dhëna për veturën që përdorej nga i dyshuari.

I dyshuari është ndaluar të mërkurën rreth orës 19:00 në pikëkalimin kufitar Kullë, dhe gjatë kontrollit i janë gjetur 12 paketime, të dyshuara me substancë narkotike heroinë me peshë të përgjithshme 6 kg e 314 gramë. Të dyshuarit S.T. (1949) i janë konfiskuar edhe dy telefona celular dhe 585 euro.

Më pas policia ka batisur shtëpinë e të dyshuarit ku janë gjetur edhe 700 gramë kokainë dhe dëshmi tjera.

I dyshuari është ndaluar për 48 orë.

"Policia, nën autorizimin e prokurores kanë kryer kontroll edhe në shtëpinë e të dyshuarit ku janë gjetur dhe sekuestruar edhe dëshmi tjera relevante për rastin, si: makineri për presimin e lëndëve narkotike, mikser për përzierje të substancës narkotike, 700 gr heroinë dhe dëshmi tjera. Mendohet se vlera e lëndëve narkotike të konfiskuara është rreth 175, 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë) euro. I dyshuari është shoqëruar në polici, është intervistuar në prezencë të avokatit mbrojtës dhe me aktvendim të prokurores ndalohet deri në 48 orë", ka njoftuar Policia.

Në rastin e dytë, po të mërkurën në Prishtinë, policia ka ndaluar një veturë pasi kishte marrë informata se disa të dyshuar po bëjnë shitblerje të narkotikëve.

Gjatë kontrollit të veturës, rreth orës 16:00, janë gjetur 17 gramë kokainë, 16 gramë marihuanë dhe 2335 euro.

"Policia ka siguruar urdhër-kontroll nga organet e drejtësisë dhe ka realizuar kontrollin në dy prona të të dyshuarit M.J., (viti i lindjes 1971, mashkull kosovar), ku janë gjetur dhe sekuestruar provat: dy qese (doza) me kokainë me peshë prej 2 gramëve si dhe një revole dhe një karikator me 6 fishekë. Gjatë operacionit policor janë arrestuar edhe: B.S., (viti i lindjes 1993, mashkull kosovar) dhe A.J., (viti i lindjes 1992, mashkull kosovar). Gjatë realizimit të këtyre rasteve, sektori qendror i hetimeve, ka bashkëpunuar ngushtë me zyrtarët kufitar, zyrtarët e rendit, njësitin me qenë- K9 dhe faranikën", ka njoftuar Policia.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#DROGA #POLICIA

Dënohet me 25 vjet burgim i akuzuari për vrasjen e djalit për çështje pronësore

Vdes në QKUK fëmija që u aksidentua para dy javësh

Zhduket një grua në Skenderaj

Vdes një pacient në Spitalin e Gjakovës, Policia po e heton rastin

Një grua gjendet e vdekur në shtëpinë e saj në Podujevë

Arrestohet 72-vjeçari i dënuar për uzurpim të pronës

Policia në Vlorë gjen sasi të madhe armësh e municioni, arreston një të dyshuar

Taboola Feed



Rusia shfaq hartën me Ukrainën brenda saj
Kohanet

Macroni nxit tensionet Francë-Gjermani
Kohanet

Kaos në Kuvendin e Malit të Zi, deputetët përplasen mes vete

Deklaratat e patriarkut serb në Tiranë


Putin: Serbia është aleate e veçantë dhe e besueshme

Kim Jong Un urdhëron ushtrinë: Bëhuni gati për luftë

Vlahoviq: Kthimi i Trumpit në pushtet rrezik për stabilitetin, i pamë qëndrimet e Grenellit
Kohanet

Inteligjenca artificiale bën që Oda Ekonomike e Serbisë "ta njohë" Kosovën
Kohanet

Rusia pretendon se ka shkatërruar HIMARS-in e parë amerikan në Ukrainë
Kohanet

Policia suedeze kërkon që të ndalohet veshja e jelekëve antiplumb
Kohanet

TË TJERA

Aksident mes kamionit e veturës në rrugën Pejë-Prishtinë, tre të lënduar

Arrestohet një i dyshuar për grabitje me armë

Gjendet sasi e konsideueshme barnash të kontrabanduara në veri

"Kobra" deklarohet i pafajshëm për akuzën për vrasje, përjashtohet nga salla për prishje të rendit

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internet a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!